



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: GJEOGRAFIA HISTORIKE

<i>Pedagogu:</i>	Departamenti i Gjeografisë, FHF
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Programi i studimit:</i>	Bachelor, Gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

Shkurtesë: Lënda “Gjeografia historike” synon në pajisjen e studenteve me trajtesat themelore të gjeografisë historike. Gjeografia historike studion hapësirën dhe kohën, duke mos u fokusuar vetëm në një zonë apo çështje por në dimensionin e kësaj, atë të kohës. Vlerësohet se e gjithë gjeografia është gjeografi historike, meqenëse për një kuptim të plotë të të tashmes kërohet një vlerësim i së kaluarës. Ajo fokusohet në çështje si të gjeografive të të kaluarës, ndryshimi i peisazhit, e shkuara në të tashmen si dhe historia gjeografike. Metodologjikisht këto mund të trajtohen në ristrukturime statistikore ose sinkronike të periudhave të kaluara ose studime të ndryshimeve gjeografike. Gjeografia historike vitet e fundit i është integruar prespektivave teorike dhe është përfshirë në sistemet kompjuterike të informacionit dhe metodave statistikore. Tradicionalisht interes të fortë kanë patur çështjet bujqësore dhe rurale të shekullit XIX, të shoqëruara me investigime të çështjeve të tjera si: arkitektura, perceptimi i peisazhit, çështjeve etike, etj.

Në përmbajtje do të trajtohen çështje të zhvillimeve të fundit në teorinë dhe metodologjinë gjeografisë historike; përpunimi i të dhënave në të; çështjeve të lidhurave me peisazhin, ekonominë rurale, popullsinë, transportin dhe komunikimin gjatë periudhës mesjetare. Më tej do të vazhdohet me kontributin e gjeografisë historike të shoqërisë bujqësore dhe rurale në vitet 1500-1900, e sjellë me shembuj nga vende të ndryshme. Zhvillimi industrial zë një hapësirë tjetër duke përfshirë studime të industrive specifike, ndryshimet industriale në strukturat rajonale, mekanizmat e ndryshimeve industriale (roli i tranzportit dhe komunikacionit, migrimi i krahut të punës) dhe impakti social (urbanizimi, trendet e

punësimit). Demografia historike na avancon kuptimin e shoqërive të kaluara përmes ristrukturimit të sjelljeve demografike të individëve dhe komuniteteve. Studimi i morfologjisë urbane përfshin trajtimin e planeve të qyteteve, formave ndërtuese dhe modeleve të përdorimit të tokës dhe ndërtesave. Studimet në vendbanimet rurale përfshijnë trajtimin e çështjeve si: karakteristikat fizike të vendeve, marrëdhëniet funksionale, klasifikimi i vendbanimeve dhe evolucioni i tyre me kalimin e kohës. Shembujt ilustrues nga bota do ndihmojnë kurrikulën. Një vend të vecantë do zënë trajtimet mbi gjeografinë historike në Shqipëri.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje. Teori dhe metodologji në gjeografinë historike. Mbi ideologjinë dhe gjeografinë historike. Gjeografia historike si evolucion i formës hapësinore.
2. Burimi i të dhënave në gjeografinë historike. Gjeografia historike dhe evidencat e saj; arkivat private si burime për gjeografinë historike; prezantimet hartografike: shembull i origjinës së qytetit.
3. Dëshmitë në terren në gjeografinë historike; një shembull negativ? Mosha e errët.
4. Ekonomia dhe shoqëria mesjetare.
5. Shoqëria bujqësore dhe rurale.
6. Gjeografia historike e ndryshimit industrial.
7. Shoqëria njerëzore dhe akomodimi në shoqëri industriale.
8. Demografia historike.
9. Morfologjia urbane. Ndryshimet gjeografike dhe pasojat e tyre në to.
11. Vendbanimet rurale. Tipare individuale të peisazhit: disa komente në organizimin hapësinor të një shoqërie rurale.
12. Imazhi i Francës dhe Parisit në kohën moderne: një problem gjeografik historik.
13. Probleme të interpretimit të simboleve të peisazhit në të shkuarën.
14. Historitë e gjeografisë; Nga navigimi në eksplorim: origjina e gjeografisë moderne; eksplorimi i institucionalizuar: shoqatat gjeografike.
15. Gjeografia historike në Shqipëri

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- | | |
|---|-------------------|
| - Detyrim frekuentimi në: | 70% të seminareve |
| - Angazhimi në seminare: | 10% e notës |
| - Testi : në javën e 7-të | 10% e notës |
| - Detyra e kursit ose ese: rreth 10 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5 : 20% e notës | |

- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim

60% e notës

- Gjithsej:

100%

Literatura bazë:

1. Morrisey J., Nally D., Strohmayr U., Whelan Y., "Key concepts in historical geography", 2014, Saga Publications Ltd.
2. Pacione M., "Historical geography : Progress and prospect", janar 2013, Taylor and Francis.
3. Alan R.H.Baker, Mark Billing, "Period and place: Research methods in historical geography", Tiranë 2010, Cambridge University Press.
4. Mike Heffernan, "Histories of geography », key concepts in geography ».
5. <http://www.journals.elsevier.com/journal-of-historical-geography/>
6. <http://geography.about.com/od/historyofgeography/>
7. http://www.history.ac.uk/makinghistory/resources/articles/historical_geography.html.
8. <http://www.jstor.org/discover/10.2307/3984475?uid=3737464&uid=2129&uid=2&uid=70&uid=4&sid=21103974651983>
9. <http://historicalgeographyresearchgroup.wordpress.com/newsletter/>
10. Buletini, Studimeve Albanologjike,
11. Etj.